



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Postuar më: 16.04.2020

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka hartuar draft Planin Kombëtar të Broadband për Shqipërinë 2020-2025.

Ky dokument strategjik do të zëvendësojë Planin Kombëtar Broadband, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 468 datë 30.05.2013, të ndryshuar në vitin 2015. Dokumenti bën rishikimin e vizionit, objektivave strategjike dhe qëllimeve për zhvillimin e infrastrukturës broadband në përputhje me zhvillimet e fundit të tregut të telekomunikacioneve, zhvillimeve teknologjike në këtë fushë, me nevojat gjithnjë në rritje për konektivitet digjital të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë të komunikimit si dhe në përgjigje të kërkesave dhe aspiratave të transformimit digjital në mbështetje të gjithë investimeve të kryera nga qeveria shqiptare në kuadër të digjitalizimit të infrastrukturës publike dhe shërbimeve elektronike.

Përsa më sipër, ftohen grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet e tyre

Dokumenta:

- [Relacioni](#)
- [Draft Plani Kombëtar i Broadband](#)

Diskutimet

Ne lidhje me “PROJEKTVENDIMIN PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË INFRASTRUKTURËS DIGJITALE BROADBAND 2020-2025”, Keto jane disa nga ceshtjet qe une doja te paraqisja per konsultim mbasi lexova draftin: 1. Si do jete qasja e adresimit te efektit mjedisor te infrastrukturës digjitale dhe masat perkatese? Asgje nuk eshte shpjeguar ne draft se si kjo do ndodhe. Nuk eshte marre mundimi te parashtrohet asnje fakt apo hap konkret ne qellimin e adresimit te efektit mjedisor dhe asnje mase e argumentuar mire. Duhet korrigjuar ky mosadresim i pasojave. 2. Cilat do jene efektet e infrastrukturës digjitale ne pasurite e paluajtshme? Vendosja e strukturave te rrjeteve celulare 5G ne qytete kryesore mund te sjelle pasoja ne vleren e pasurive e paluajtshme ku infrastruktura do instalohet. Nuk eshte adresuar si ceshtje. Per shkak te frekuences me rreze te shkurter duhet instaluar me shume antena ne qendra urbane. (1) Qytetaret, pronat e te cileve preken, duhen informuar dhe u duhet dhene nje ze per te reaguuar. 3. Cilat do jene pasojat shendetesore te instalimeve prane qendrave urbane dhe shkollave? Sa larg duhen instaluar nga shkollat, per shembull, 20 metra, 50 metra? Infrastruktura duhet te kete parametra sigurie dhe te perfshije shqetesimet shendetesore. Në prill 2019, qeveria belge ndaloi një test 5G në Bruksel për shkak te shqetësimeve se rrezatimi nga stacionet bazë mund të jetë i dëmshëm. (2) Anëtarët e Parlamentit në Hollandë gjithashtu po i bëjnë thirrje qeverisë të kontrolloje probelmatikat e ngritura mbi 5G-ne. (3) Zvicra po merr hapa për të monitoruar ndikimin e 5G te njerëzit. (4) Në vitin 2011, Organizata Botërore e Shëndetit tha që telefonat celularë mund të shkaktojnë disa kancere të trurit, duke lënë të hapur mundësinë që ekziston një lidhje midis kancerit dhe rrezatimit të celularit. (5) Sistemi 5G ka frekuence edhe me te larte akoma se ato te viti 2011 dhe Shqipëria nuk ka pse te jete pararoje e eksperimenteve. (6) 4. Pse instalimi i struktures 5G shihet si prioritet i qeverise? A nuk duhet te jete ajo investim privat i atyre qe do marrin fitime financiare nga ai rrjet, kompanite celulare? Shqiperi ka nevoje per internet dhe e kuptoj rritjen 0.1 te ekonomise me instalimin e nje rrjeti modern digjital, por rrjeti 5G nuk ka pse te paguhet nga taksapaguesit shqiptare per te pasuruar kompanite celulare. Broadbandi me fije

optike eshte me i lire dhe me i sigurte. Perfituesit kryesore te 5G nuk jane fshatrat e thella, por kompanite celulare. A nuk duhet te kete nje studim qe krahason matshem keto aspekte dhe jo thjesht iluzione nga grupet e interesuara? 5. A ka mjete per te mos monopolizuar broadbandin dhe shmangje te vendosjes se cmimeve nga ofruesit ashtu si ka ndodhur edhe me pare me tarifat celulare ku kompanite kishin bere ujdj menjane dhe vendosen cmime te larta bashkarisht? Si do demokratizohet plani i shperndarjes? 6. Ne draft ka thirrje nga disa plane te interesuara per rritje cmimesh per ofrimin e internetit te qytetaret. Nuk me duket ogur i mire qe kjo te jete shqetesim ne nje draft qeveritar. A nuk i duhet lene kjo ekonomise se tregut? 7. Ne objektivat startegjike, permendet qe nje qytet kryesor do pajiset me lidhje 5G nga fundi i 2025. Duhet transparence dhe jo plane ne ajer. Duhet te jene te shkruar me te zeze ne te bardhe dhe qytetaret te informohen. Qeveria ka qene ne lartesine e duhur per t'u shprehur gjate Covid-19. Kjo duhet te ndodhe edhe kur ne qytete shqiptare behen eksperimente te kesaj natyre. 1.

<https://newyork.cbslocal.com/2018/05/29/5g-cell-phone-service/> 2.

<https://www.brusselstimes.com/brussels/55052/radiation-concerns-halt-brussels-5g-for-now/> 3.

<https://www.emfsa.co.za/news/5g-the-netherlands-political-concern-about-the-effects-of-radiation-on-public-health-is-growing/> 4. <https://www.reuters.com/article/us-swiss-5g/switzerland-to-monitor-potential-health-risks-posed-by-5g-networks-idUSKCN1RT159> 5. <https://www.cnet.com/news/who-cell-phones-may-cause-cancer/> 6. <https://www.facebook.com/terryrexx/videos/3060905413973185/>

Postuar më: 19.04.2020 08:23

Gentian Suçi